

Në përcaktimin e vlerës së sendit, përmbaruesi gjyqësor bazohet në metodologjinë e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar. Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor palët mund të bëjnë ankim, sipas rregullave të parashikuara në nenin 610 të këtij Kodi."

Me rastin e hyrjes në fuqi të ligjit 114/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", si dhe në kushtet e mosarritjes të marrëveshjes për vlerën e sendit të sekustruar, midis kreditorit dhe debitorit, do të duhet që vlera e sendit të sekustruar të caktohet prej përmbaruesit gjyqësor me asistencë teknike të ekspertit të liçensuar. Zhvillimi i procedurave përmbarimore në kushtet e lartpërmendura është i pamundur për shkak të mosnxjerrjes së Udhëzimit përkatës prej Këshillit të Ministrave konform parashikimit të kryer në këtë dispozitë urdhëruese të ligjit. Mungesa e Udhëzimit në fjalë, ka krijuar premisat e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikundër sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së RSH apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të RSH, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor apo K.Pr.C.

Kjo situatë shtron nevojën e ngutshme për marrjen e masave sa më parë të jetë e mundur për nxjerrjen e Udhëzimit nga ana e Këshillit të Ministrave me qëllim zhvillimin e procesve të rregullta ligjore nga ana e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv

Në kushtet, si më sipër prezantuar, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në sanksionimin e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se : "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike", si dhe nenit 21/b, se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen".

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave sa më parë e mundshme për nxjerrjen e udhëzimit për përcaktimin e metodologjisë në caktimin e vlerës së sendit të sekustruar, prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, konform parashikimit të kryer në nenin 7 dhe 11 të ligjit 114/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkresë.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI

Konceptoi dhe Daktilografoi: A.Gjoleka